



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

i mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11.6.2024, duke filluar në orën 8:30.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Dhuvara Jahaj Retkoceri, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Mirsad Vitia.

Mungoi: Bahri Gashi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përparim Rama - Kryetar i Kryeqytetit, Arbër Sadiki – drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Mjedisor, Fatos Dibra - udhëheqës i Zyrës ligjore, Osman Bllaca - auditor, Valbona Ahmeti-Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Izet Sadiku - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Bardh Krasniqi – drejtor i Drejtorisë së Sportit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katër të Komitetit për Politike dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për rritjen dhe bartjen e mjeteve nga tejkalimi i planit për të hyra vetjake nga viti 2023 në vitin 2024;
3. Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024;
4. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve;
5. Propozim-vendimi për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e humanistit Dr. Gani Demolli;
6. Propozim-vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), 2024-2032;
7. Propozim-vendimi për themelimin e Komisionit të Kuvendit lidhur me shfrytëzimin e Banesave të Komunës së Prishtinës në Bregun e Diellit, Fusha e Pajtimit dhe në Hajvali;
8. Raporti vjetor i punës i Ndërmarrjes publike lokale “Gjelbër” SH.A, për vitin 2023, si dhe Raporti i punës për periudhën janar-prill 2024;
9. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Gëzim Sveçla** tha se e kanë marrë një email shefat e grupeve, kryetari dhe kryesuesi prej banorëve, të fshatit Shkabaj, që lidhet me atë që është deklaruar në seancën e kaluar, kur drejtoresha e pronës e ka konfirmuar se ka interes për blerjen e një parcele në Shkabaj dhe ata na kanë dërguar një kërkesë, së bashku me peticion që kjo çështje të hyjë në rendin e ditës në mbledhjen e radhës, që kuvendi të vendosë për blerjen e parcelës. Nuk e di ndoshta zyra ligjore, mundet me na ndihmuar këtu, AKP-ja i ka bërë një ofertë komunës për blerjen e pronave, sepse komuna ka mungesë të pronave.

Fatos Dibra: nuk është çështje e kuvendit dhe në rastet e tjera, AKP dërgon kur ka për të privatizuar diçka edhe në vendet e tjera për shkak të territorit të komunës, e ka për obligim të pyes komunën se a ke interes për blerje, duhet me iu përgjigj nëse është po.

Gëzim Sveçla: parashtroi disa pyetje për Zyrën ligjore se a ia kanë kthyer përgjigjen, por tani cilët janë hapat e radhës, a duhet kuvendi diçka ndonjë miratim. Këtu janë problemet e vazhdueshme me xhami, me shkollë, e ajo i zgjedh këto probleme. Kur është blerë kjo pjesa te tulltorja, a ka pasur kuvendi ndonjë punë aty?

Fatos Dibra: dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësi.

Nora Kelmendi: nuk ka dal në proces, para se me iniciuar procesin ata pyesin se a po doni ta bleni.

Fatos Dibra: tani duhet me i parapri një marrëveshje në mes të kryetarit të komunës, d.m.th. njëfarë kontrate, por të shohim se ku ka mbërri procesi dhe mos të flas përmendësh pa letra.

Kryetari: tha se e kanë pranuar letrën prej AKP-së, që po dëshirojnë me privatizuar, faktikisht kemi treguar se kemi interes dhe se po dëshirojmë ne me shpronësuar atë pronë dhe është dërguar kërkesa zyrtare prej Drejtorisë së Pronës, për të privatizuar komuna atë parcelë.

Bardh Krasniqi: kërkoi që të hyjë si pikë e rendit të ditës Propozimi për përkrahje financiare të klubeve sportive të kryeqytetit.

Gëzim Sveçla: tha se jemi dakorduar që çështjet të cilat nuk janë urgjente mos me i fut në rend dite.

Bardh Krasniqi: tha faktikisht është emergjente, kualifikimi për gara evropiane.

Gëzim Sveçla: cilat janë emergjente, a e ke fjalën për Klubin e basketit Prishtina, që i ka marrë 1,150.000.00 euro, për sponzorizim.

Kryetari: pyeti prej kujt i ka marrë.

Bardh Krasniqi: tha ne jemi duke folur për të gjitha klubet, nuk është puna për me ia dhënë Sigal Prishtinës, por të gjitha klubet e kryeqytetit

Gëzim Sveçla: tha se nuk ka emergjencë, është në qershori apo në fillim të korrikut mbledhja e radhës dhe mundeni me i sjellë, kjo që po e bëni është shkelje sidomos po ia japim një OJQ-je, që e ka ndërruar emrin dhe që vitin e kaluar, i ka pasur 1,150,000.00 euro dhe i ka marrë prej Ligjit për sponzorizim. A e dini që kjo është shkelje ligjore, tek të gjeturat e auditorit kjo po del që është shkelje ligjore.

Nora Kelmendi: tha se nuk bon pa thirrje, hiç mos u merrni me këtë nuk ia aprovojmë, pa shpallje publike.

Gëzim Sveçla: tha ne jemi duke bërë një rregulllore, për subvencione.

Bardh Krasniqi: tha se bëhet kategorizimi, ku bëhet me tituj me të arriturat, me rezultatet, me përfaqësim, po mendoj ashtu bëhet kategorizimi për ata ndihmohen klubet, që të na përfaqësojnë, të na japin titujt dhe ta ngritin kryeqytetin diku.

Jeta Rafuna: tha a mundemi me i pa ato materiale, se nuk po e dimë as për cilat klube është fjala.

Gëzim Sveçla: tha silleni letrën nga auditori dhe në rregull jemi, aktivitetet përkrahen si projekte, le ti sjellin projektet, ne vazhdimisht i përkrahim projektet i kemi përkrah.

Kryetari: pyeti Bardhin sa klube janë aty.

Bardh Krasniqi: tha janë 5 klube, 1 federatë për kampionat evropian, tri gjenerata që e përfaqësojnë

Federatën e hendballit, që me vendos me i përkrah, sepse është një organizim masiv dhe është 1 OJQ që ka aktivitet në kategorinë e sporteve.

Kryetari: tha se ne e kemi për detyrë me i përkrah, është çështje e vizionit tonë normal.

Nora Kelmendi: pyeti pse nuk po e publikon thirrjen për subvencionim.

Kryetari: tha sepse nuk mundemi me i përkrah.

Osman Bllaca: tash e kanë ndryshuar edhe në rregullore që thirrjet që bëhen nga kryetari, këto nuk është adekuate sepse pengon vetëm hapin e konkurrencës dhe nuk kërkohet zhvillimi i konkurrencës, sipas rregullores.

Gëzim Sveçla: pyeti cila rregullore, a është gjetje e auditorit kjo çka po bëhet.

Osman Bllaca: tha se rregullorja nga ministria që është kjo formë, kjo formë e pengon vetëm hapin e konkurrencës, por kur të janë këto situata të jashtëzakonshme.

Nora Kelmendi: tha se nuk është e jashtëzakonshme.

Osman Bllaca: tha në rregulloren e ardhshme përmirësohet sepse është rekomandim.

Nora Kelmendi: pyeti Fatosin, si udhëheqës i zyrës ligjore, a ka të drejtë që pa thirrje publike me i sjellë këto subvencione në KPF.

Fatos Dibra: dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga parafolësja.

Bardh Krasniqi: tha se ka ardhur me propozim që është shumë i rëndësishëm, nuk jemi duke folur për Sigal Prishtinën, por për klube të Prishtinës, këtu e keni të gjithë dokumentacionin e klubave që na përfaqësojnë, në gara edhe vendore edhe ndërkontaktare. Nëse doni të shihni materialin këtu e kam, ne normalisht kemi me u munduar me e fut si pikë në kuvend.

Gëzim Sveçla: tha ne e kemi një praktikë në Komitetin për Politikë dhe Financa, që çështjet të cilat nuk janë emergjente dhe çështjet të cilat kanë të bëjnë me buxhet, të cilat kemi me dhënë para nuk e fusim përmes KPF-së, pa pasur ndonjë urgjencë të madhe, kjo është e tëra.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë e Financa.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë e Financa.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për rritjen dhe bartjen e mjeteve nga tejkalimi i planit për të hyra vetjake nga viti 2023 në vitin 2024.

Pika e tretë

Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024.

Pika e katërt

Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve.

Lidhur me këto tri pika, në pika të shkurta dha sqarime **Valbona Makolli**, e cila tha siç jeni në dijeni me ligjin e ri, për vitin 2024, Ministria e Financave e ka bërë vetë bartjen, ashtu siç kanë qenë mjetet nëpër projekte, janë bartur nëpër kode që i kemi, duke minusuar grantin qeveritar. Si rezultat i buxhetit 2024, Ministria e Financave na ka njoftuar si të bëhet rialokimi i mjeteve dhe tejkalimi i të hyrave për arsyet se

nuk kemi ndonjë udhëzim administrativ se si ka qenë përpara me u bërë dhe në koordinim me ata, na kanë udhëzuar që secilën prej tyre rialokimeve dhe tejkalimi i të hyrave të kenë një kod të veçantë, kurse ne së bashku me drejtoretitë besoj se në Kuvendin Komunal, do t'i arsyetojmë këto rialokime të mjeteve. Sa i përket të hyrave për vitin 2024, kemi pasur 3,339.999.30 euro/cent, ku janë bartë paga dhe mëditje 150,000.00 euro, me kërkësë së Drejtorisë së Arsimit, të punësimit joformal, duhet të bëhet pagesa e arsimtareve në këtë kategori tek mallrat dhe shërbimet, janë obligimet e bartura nga viti i kaluar dhe investimet kapitale të cilat janë për tejkalim sidomos tek tatimi në pronë dhe tek infrastruktura rrugore, ku sipas Ministrisë së Financave janë programe që nuk mund të tejkalojen dhe janë bërë sipas udhëzimeve të tyre. Këto janë për dy vendimet, e kemi edhe vendimin e tretë, i cili është i vitit 2024, ndërtimi, mirëmbajtja dhe ndërrimi i ashensorëve për kryeqytet sipas Ministrisë së Financave nuk janë, duhet të kalojë në kategorinë e subvencioneve dhe ka kaluar në rezervë. Kështu që këto 150,000.00 euro, të cilat janë rezervë tash orientohen tek investimet kapitale të të njëjtës kategori.

Osman Bllaca: tha se paska ndodhur një gabim teknik te vendimi i parë për rritjen dhe bartjen e mjeteve, nga teikalimi i planit të tē hyrave vetjake duhet tē ndryshohet vlera.

Mirsad Vitia: tha e para ishte ajo që e potencoi Osmani dhe tjera si pyetje është se kodet e projekteve po mungojnë te tabela, si p.sh. shumica nuk janë, i kemi vetëm dy.

Valbona Makolli: tha se i keni tek mallrat dhe shërbimet, është vetëm kodi nga Drejtoria e Administratës, mundemi me i vendosur nuk është problem.

Nora Kelmendi: parashtroi disa pyetje këto mjete prej 150,000.00 euro, për shkolla të aftësimit joformal, cilat shkolla, për çka, pse po i bartni, pagat, orët shtesë e të tjera. Mandej administrata dhe personeli 618,000.00 euro, shërbimet e shëndetësisë, sporti dhe rekreacioni, arsimi dhe administrata, për mallra dhe shërbime të pagave me rend, ndërtimi i tregjeve të gjelbra, cilat tregje.

Valbona Makolli: dha përgjigje lidhur me pyetjet e parashtuara nga parafolësja.

Nora Kelmendi: pyeti në cilin kod buxhetor i keni pasur ashensorët.

Nora Kelmendi: pyeti në cëm këtë buxhetet. Në këtë pjesë
Valbona Makollı: tha kjo ka kaluar në rezervë, vendimi nga viti i kaluar, ku shumica e qytetarëve kanë kërkuar me bashkëfinancim ose kanë probleme me ashensorë sidomos ndërtesat e vjetra dhe me kërkesë të tyre i kemi edhe kërkesat e qytetarëve me i fut në projekt.

Kryesuesi: tha se u përkrah Propozim-vendimi për rritjen dhe bartjen e mjeteve nga tejkalimi i planit për të hyra yetiakë nga viti 2023 në vitin 2024.

Buqazim vendimi për rialokimin e mijteve të bartura në vitin 2024, dhe

Propozimi-vendimi për transferimin e mjetave të saj tare në Kuvend për miratim.

Rike o postö

**Pika e peste
Propozim-vendimi për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e humanistit Dr. Gani Demollit**

Lidhur me Propozim-vendimin për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e humanistit Dr. Gani Demolli, në pikë të shkurta informoi Izet Sadiku, se pas iniciativave që kemi pasur dhe në bashkëpunim me kryetarin jemi pajtuar që Qendra e Mjekësisë Familjare që nuk ka qenë e emëruar të emërohet me një emër, si emrin e Gani Demollit, ku të gjithë ne e njohim Gani Demollin, për organizimin e që e ka bërë me "Nënë Terezën", e themeluar në vitin 1992, e cila ka pasur vetëm 17 punëtorë kur është themeluar. Gjatë zhvillimit të saj ka pasur 1665 personel, të cilët kanë punuar pa pagesë, ndërsa ky institucion ka funksionuar në gjithë Kosovën, faktikisht i ka pasur 104 ambulanca spitalore në tërë Kosovën, ku përvëç dhënies së shërbimeve shëndetësore janë dhënë edhe shërbimet edukativo-arsimore

ku shumica e studentëve të Fakultetit të Mjekësisë dhe shkollat e mjekësisë, në komunat e ndryshme kanë kryer praktikë, faktikisht ky shërbim ka dhënë 4,000.000.00 ekzaminime, për periudhën 7-vjeçare. Gjatë vitit 1996 doktor Ganiu ka qenë bartës i procesit të vaksinimit kundër paralizës së fëmijëve, është kërkuar nga ndërkombëtarët një person që i besojnë qytetarët shqiptarë, se atëherë kishte rezerva edhe të vaksinimit dhe në fund në vitin 1998 së bashku me UNICEF-in dhe mjekët e botës francezë së bashku me ekipin, janë dërguar ekipet në zonat e luftës. Unë mendoj që vendosja e emrit të tij në Qendrën e Mjekësisë Familjare bën nder.

Gëzim Sveçla: tha se e përkrahim edhe në seancë, vetëm se e kam një shqetësim mos po krijojmë njëfarë precedani dhe me u vërvshuar prej kërkeseve, për emërimë të tilla ne kemi plotë mjekë dhe personalitetë të fushës së mjekësisë që kanë dhënë kontribute të mëdha ndër vite, për çështje të caktuara, këtu është problemi se secili e ka kontributin e vet, secili ka dhënë diçka prej vetës, dikush edhe jetën, për çështje të caktuara që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm. Unë mendoj se duhet me pas emrin që e kanë, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Spitali i Përgjithshëm, tash Universiteti "Hasan Prishtina" është duke u bërë një debat me ia heq emrin "Hasan Prishtina" me mbetur vetëm Universiteti i Prishtinës, kjo është sepse edhe si kuvend edhe si institucion dalim në një pozitë të papëlqyer kur të vijnë këto kërkesa dhe ne mos me pasur mundësinë me i akomoduar.

Izet Sadiku: tha se për këtë çështje kemi pasur diskutime dhe iniciativa edhe prej organizatave të ndryshme, prej gazetarëve për Gani Demollin, ka pasur propozime dhe tek kryetarit që i ka dhe kemi diskutuar me punëtorë shëndetësorë dhe nuk e mendoj se ka ndonjë mjek të jetë më meritor.

Leutrim Retkoceri: në rregull drejtë, është propozimi vetëm se është mirë Qendra e Mjekësisë Familjare 1, Gani Demolli, Qendra Kryesore Mjekësisë Familjare, Gani Demolli, vetëm se mos me u tjetërsua Gani Demolli, ne do të votojmë, do të votojmë të gjithë.

Milazim Vitija: tha se është i pakontestueshëm kontributi i Gani Demollit, unë e ti dhe shumë të tjerë këtu që e mbajmë mend aktivitetin e tij, atëherë ka qenë një pushtet paralel edhe i arsimit, në këtë rast edhe i shëndetësisë dhe kemi pasur raste me i dërguar njerëzit edhe me u shërua aty, jo vetëm në ordinancën "Nënë Tereza" që ka qenë atje, por edhe në terren që ka dalë dhe i ka vizituar njerëzit dhe e ka dhënë kontributin e tij, para luftës, por edhe gjatë luftës, ne jemi të gjithë që Qendra e Mjekësisë Familjare, të emërohet me emrin Gani Demolli.

Mirsad Vitia: pyeti se a është institucioni i parë që emërohet me emër.

Izet Sadiku: tha në Prishtinë po.

Gëzim Sveçla: pyeti a ka edhe në QKUK diçka.

Milazim Vitija: u përgjigj se Shpëtim Robaj është QKUK-ja.

Kryesuesi tha se u përkrah Propozim-vendimi për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e humanistit Dr. Gani Demolli dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), 2024-2032

Lidhur me Propozim-vendimin për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), 2024-2032 në pika të shkurta informoi Arbër Sadikin se sot jemi takuar për iniciimin e diskutimit publik, ku kemi mundësi 30 ditë për të diskutuar edhe me publikun edhe me grupe dhe me të gjithë ata që i kanë të paqarta shqetësimet, mospajtimet etj. Ju kisha ftuar që gjatë kësaj kohe me qenë sa më afër juve, për çfarëdo informate që mendoni, nëpër takime kështu zyrtare në qoftë se keni

ndonjë pyetje konkrete, ajo çka nga ana ime është në interes me e sqaruar sa më tepër gjëra deri në ditën kur të del në aprovim final.

Nora Kelmendi: tha se nuk e keni dorëzuar, shkresën përcjellëse se ku mund të jenë dallimet në mes të PZHK-së së vjetër dhe PZHK-së së re, që ne me bërë krahasimin jo vetëm ne por edhe qytetarët, me na sjell dhe me i parë se ku janë dallimet, nuk është në fuqi ajo, tash fillojmë me skedar çka keni dorëzuar, në dokumente tek ne, p.sh. në pjesën tekstuale që quhet PZHK-Prishtina, 2023-2031, Mirëdita Nëntor, nuk hapet hiç, raporti i vlerësimit strategjik mjedisor i PZHK-së, e keni sjell të vitit 2021, ju e dini se jemi në vitin 2024 edhe këtë Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor nuk e keni përditësuar, pse nuk e dimë: Në dokumentacion e kemi vendimin për formimin jo komisioni dhe vendimin e formimit të grupit punues, të dyja janë të vitit 2018, pse nuk janë përditësuar dhe nuk e keni formuar. Mandaj e keni një formim të komisionit në vitin 2021, dy vendime të tjera për hartimin e PZHK-së dhe Hartës zonale, si dhe një vendim të formimit të komitetit konsultativ që nuk kërkohet hiç me ligj, por ju e keni formuar, ky komitet konsultativ nuk kërkohet me ligj. I keni në dosje dy raporte, raporti i takimeve me qytetarë dhe një raport tjetër me komitetin konsultativ, i kam krahasuar të njëjtë janë, vetëm emrat ia keni vendosur ndryshe dhe nëse shkon kjo PZHK në diskutim publik, por nuk ka kuptim me i vendosur dy dokumente vetëm me ia ndryshuar emrin e me qenë të njëjta. Mandaj në takim me qytetarë, nuk keni diskutuar hiç për PZHK-në, por jeni marrë me problematika të qytetarëve si me bërë një diskutim publik, p.sh. Kodra e Trimave, kurri nuk është përmend te PZHK-ja, keni përmend hartat zonale për PZHK-në, kurse nuk keni shkuar me u takuar me qytetarë për PZHK.

Jeta Rafuna: tha se është hap shumë i mirë vënia në diskutim e Planit Zhvillimor Komunal, vetë se pak jemi vonuar në këtë proces, të dërgohet në diskutim publik dhe më pas t'i jasin vërejtjet dhe kërkesat të gjitha grupet.

Gëzim Sveçla: drejtor çka ka thënë ministria për PZHK-në.

Arbër Sadiki: dha sqarime për pyetjen e parashtuar nga parafolësi.

Gëzim Sveçla: tha nuk është problemi me u përmirësuar PZHK-ja, ju duhet me përmirësuar mënyrën, ju duhet me u përshtat, këtë aspektin ligjor a janë të mira apo jo, unë vetëm po ju lexoj pikën e shtatë, te të gjeturat e ministrisë, raporti i VSM-së i projektit PZHK, i Kryeqytetit Prishtinë, duhet të hartohet për gjeturat e ministrisë, eshtë i hartuar PZH-Komunal i Gjakovës. Po ashtu pika nëntë projekti Plani Kryeqytetin Prishtinë, eshtë i hartuar PZH-Komunal i Gjakovës. Po ashtu pika nëntë projekti Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2023-2031, ka ndryshuar profilin dhe vlerësimin e gjendjes pa ndonjë kërkësë paraprake dhe pa arsyetim, eshtë në kundërshtim me kërkesat ligjore, neni 7, neni 8, i udhëzimit administrativ, nuk mundet me vazhduar kjo paligjshmëri.

Nora Kelmendi: tha ju tregova unë Arbër cilat janë joligjore le ti rregullon, ndoshta ju bien vitin e ardhshëm, tamam ju përfundon mandati.

Gëzim Sveçla: propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet prej rendit të ditës, nuk mundemi na kështu çështje joligjore me fut në seancë.

Fatos Dibra: dha sqarime se rendi i ditës përcaktohet prej kryesuesit të Kuvendit dhe Kryetarit të komunës, KPF – ja shqyrton dokumente që vinë këtu dhe jap rekomandime, kompetencë e KPF –së me heq ose me shtuar pika të rendit të ditës nuk është, eshtë bërë praktikë e gabuar.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Planifikimin, Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative, ministria ka pasur kohë 30 ditë me kthyer një përgjigje për miratim, për pëlqim dhe ligji thotë: nëse kjo dështon, kjo propozohet e miratuar.

Leutrim Retkoceri: pyeti se a kanë bërë ankesë në kalimin e heshtjes administrative që e ka bërë ministria.

Fatos Dibra: tha se drejtoresha Mimoza ka bërë shumë shkresa në ministri.

Leutrimi Retkoceri: kërkoi se a ka mundësi me iu dërguar ato shkresa që Mimoza i ka dërguar në ministri përgjigje, na i dërgo me email e ne po i analizojmë, asamblistët dhe të shohim ku ka mbet përgjegjësia se nuk është e qartë.

Fatos Dibra: dha sqarime lidhur me çështjet e parashtruara nga parafolësi.

Leutrim Retkoceri: tha edhe një pyetje pse e keni heq mundësinë e ankesës në heshtje administrative edhe te institucionet sepse edhe pala me institucionin kur është i mundësohet kjo edhe institucionit i mundësohet dhe pyeti kujt po i konvenon kjo lojë e mospërgjigjive.

Fatos Dibra: dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

Leutrim Retkoceri: tha unë po flas si KPF dhe si asamblistë kemi informata zero sa i përket procesit, asnjë email asnjë shkresë as njoftim që ka hartim apo punë nuk e kemi, andaj kemi të drejtë me kërkuar çasje se jemi duke folur për një plan që determinon zhvillimin tonë për 8 vite apo më shumë.

Gëzim Sveçla: tha ne jemi duke fol për dokumentin kryesor që ka të bëjë me zhvillimin e kryeqytetit në 10-vjetorin e ardhshëm dhe nëse një dokument të tillë ka kaq shumë të gjetura nuk na bënë nder askujt që me lejuar që kjo me kaluar, duhet kthyer përgjithmonë ligjshmërinë në Kuvendin Komunal të Prishtinës.

Unë insistoj që propozimin tim që me heq këtë pikë nga rendi i ditës dhe ta hedhni në votim.

Arbër Sadiki: tha ne këtu e kemi dokumentin për ta vënë në diskutim publik pasi ato pika na kanë ardhur pas afatit kemi me i shikuar çka kemi mundësi me i përmirësuar në mënyrë që dokumenti me dal sa më i mirë.

Nora Kelmendi: tha rregulloni dokumentin e pastaj e hedhim në diskutim publik.

Milazim Vitija tha në KPF- në e parë kam kërkuar me qenë Harta zonale në mënyrë që të kemi edhe plane urbanistike se jemi vonë sa i përket kësaj pune, jemi duke diskutuar për një dokument shumë të rëndësishëm për kryeqytetin dhe mendoj nuk ka asgjë të keqe të shkojë në diskutim publik, të shkojnë në Kuvend gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet të inkorporohen në këtë dokument që të bëhet Harta zonale dhe të vazhdojmë me plane urbanistike.

Mirsad Vitia: pyeti sa duhet kohë të rregullohet dokumenti me vërejtjet që i parashtri Nora.

Arbër Sadiki: tha se beson se janë lëshime teknike dhe shumë shpejt mundemi me i përmirësuar.

Kryesuesi e qiti në votim propozimin e zotëri Sveçla për me larguar nga rendi i ditës **Propozim-vendimi për lënien në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), 2024-2032**

Kryesuesi konstatoi se me 5 pika për, 3 kundër dhe 2 abstenime, hiqet kjo pikë nga rendi i ditës. **Propozim-vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), 2024-2032.**

Pika e shtatë

Propozim-vendimi për themelimin e Komisionit të Kuvendit lidhur me shfrytëzimin e Banesave të Komunës së Prishtinës në Bregun e Diellit, Fusha e Pajtimit dhe në Hajvali.

Jeta Rafuna tha ky është propozim –vendimi që e kemi marrë më herët, tash po na themelohet një komision për t'i shqyrta banesat.

Nora Kelmendi: tha se janë komisionet.

Jeta Rafuna: tha se tani formohen komisionet e Kuvendit për t'i shqyrta.

Gëzim Saveçla: u interesua kush e ka bërë këtë propozim, prej kujt ka ardhur propozimi.

Jeta Rafuna: tha nga Drejtoria e Pronës.

Osman Bllaca: tha kjo pikë ka ardhur vetëm me u caktuar anëtarët e komisionit.

Gëzim Sveçla: tha pasi nuk ka propozues për këtë pikë dhe nuk kemi material, propozoj të largohet kjo pikë nga rendi i ditës.

Jeta Rafuna: tha se është që mos të hiqet pika, por të vijë drejtoresha dhe të na jep sqarime.

Leutrim Retkoceri: tha kushdo që është propozues që ta ka dërguar ty kryesues me hedh në rend dite një dokument që të vjen nga lart e nuk e dinë prej kujt vijnë mos i prano. Këtë si na e kanë sjell neve për banesat, a bënë me na sjell edhe të parkingut te QKUK –ja që iu ka vazhduar kontrata spitalit Amerikan, a bënë t'i sillni ato lëndë sepse u tejkalua Kuvendi me iu vazhduar kontrata për pronën publike.

Gëzim Sveçla: tha kemi thënë nëse nuk është propozuesi me heq pikën e rendit të ditës se nuk po ta respekton as KPF-në.

Kryesuesi e hodhi në votim që të hiqet nga rendi i ditës pika **Propozim-vendimi për themelimin e Komisionit të Kuvendit lidhur me shfrytëzimin e Banesave të Komunës së Prishtinës në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtimit dhe në Hajvali** pasi që nuk është propozuesi.

Kryesuesi konstatoi se me 7 pika për, 2 kundër dhe 1 abstenim, hiqet kjo pikë nga rendi i ditës **Propozim-vendimi për themelimin e Komisionit të Kuvendit lidhur me shfrytëzimin e Banesave të Komunës së Prishtinës në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtimit dhe në Hajvali**.

Pika e tetë

Raporti vjetor i punës i Ndërmarrjes publike lokale “Gjelbër” SH.A, për vitin 2023, si dhe raporti i punës për periudhën janar-prill 2024

Leutrim Retkoceri: i parashtri pyetje Zyrës ligjore sikur në situatën kur komisioni i aksionarëve është me një aksionar a është shoqëri aksionare ajo.

Fatos Dibra: u përgjigji se komisioni i aksionarëve me një anëtar nuk është funksional.

Leutrim Retkoceri tha hartuesi është mirë me marrë një interpretim prej Zyrës ligjore se a përbëhet komisioni i aksionarëve prej një anëtarë dhe aksionari e kuption kuptimin ligjor, është mirë me qenë të ftuar edhe kryeshefi nëse e ka përgatit, menaxhmenti dhe aksionari dhe mandej Kuvendi pasi të merr interpretimin me vendos kush raporton për reportin.

Fatos Dibra: dha sqarime lidhur me çështjet e parashtruara nga parafolësi.

Mirsad Vitia: pyeti nëse komisioni është jofunksional a e ka ligjërisht detyrë me reportuar para nesh.

Fatos Dibra: ju përgjigji pyetjes së parashtruar nga parafolësi.

Dhurata Jahaj Retkoceri: tha nëse është i caktuar nga kryetari i raporton kryetarit, nëse është i Kuvendit i raporton Kuvendit.

Milazim Vitija: tha në vitin 2014 e kemi kryer mandatin dhe kemi ardhur në mandatin e ardhshëm që në atë mandat nuk kam qenë dhe kemi reportuar para Kuvendit për punën e viti paraprak, në këtë rast d.m.th. pasi është fjala për vitin paraprak kishte qenë mirë me ardhur se e ka përgjegjësi secili me ardhur me reportuar për vitin 2023.

Fatos Dibra: tha ata duhet me ju përgjigj Kuvendit, Kuvendi i ka vendos aty dhe Kuvendi kur do mundet me i larguar.

Kryesuesi: tha se u përkrah **Raporti vjetor i punës i Ndërmarrjes publike lokale “Gjelbër” SH.A, për vitin 2023, si dhe raporti i punës për periudhën janar-prill 2024** dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Të ndryshme

Gëzim Sveçla: ceku çështjen e mbledhjes solemne të shpalljes “Qytetar nderi” Tony Blerit, ku tha se nuk është rregull me i vënë asamblistët para një akti të kryer, ka pasur edhe një tendencë për sot me u shpall

një rrugë, m'u emërtuar, për vendimet të cilat i merr qëndrim kuvendi ose është kompetencë e kuvendit nuk mundemi mos me diskutuar në kuvend përpos nëse paraprakisht pajtohem për këtë punë, para kuvendit i thirr shefat e grupeve e jo të na anashkaloni. Po ashtu tha duhet një rregullore e cila i mungon Komunës së Prishtinës e është kompetencë e Komitetit për Politikë e Financa me iniciuar këtë rregullore për ndarjen e dekoratave dhe çmimeve, nuk bënë me vazhduar kjo praktikë tutje.

Kryesuesi: tha se ka biseduar me kabinet dhe i kanë thënë se e ka kohën e kufizuar Tony Bleri për këtë arsyë nuk kemi mundur t'i përfshjmë anëtarët e kuvendit apo kush ka dashur me mbajtur ndonjë diskutim kjo ka qenë arsyja edhe unë pajtohem me ty se nuk është në rregull.

Milazim Vitija: kishte qenë mirë paraprakisht shefat e grupeve m'u dakorduar, po votojmë se nuk diskutohet për figurën e Tony Blerit, secili prej neve i di meritat e tij dhe shefat e grupeve neve me na treguar që jemi pajtuar me votuar të gjithë. Po ashtu parashtroi edhe çështjen e shujtës së punëtorëve të Komunës së Prishtinës, ku mendon dhe beson se të gjithë janë m'i ndihmuar, m'i përkrah këta punëtorë më shumë prej 5 € shujtë për vitin 2023 - 2024 në ditë dhe ta marrim një vendim a ka bazë ligjore a jo mos t'i lëmë këta punëtorë, nëse e voton Asambleja komunale këta a i marrin me gjykatë apo me përmbarues është problem i tyre. Unë po e propozoj si pikë të hyjë në rend dite dhe në Kuvend të diskutojmë.

Gëzim Sveçla: tha se është marrë me Ministri të Financave për këtë çështje nuk ka hapësirë ligjore m'u rregulluar kjo punë. E vetmja mundësi është të bëhet si investim kapital dhe nuk ka mundësi ndryshe, as si kontratë as si ndihmë.

Milazim Vitija: i parashtroi pyetje Zyrës ligjore pse gjitha komunat tjera ju paguajnë arsimtarëve shujtat dhe rrogat jubilare, pse Prishtina prolongon dhe ankohet me paguar kamatë vjetore 8 %, pse edhe Prishtina mos me ju mundësuar m'i marrë edhe ata pasi edhe gjykata dhe përmbaruesi po ua realizon.

Fatos Dibra: tha se nuk ka njohuri si kanë vepruar komunat tjera.

Valbona Makollı: dha sqarime shtesë lidhur me çështjen e shujtave të cekur nga Milazimi.

Leutrim Retkoceri: tha sa i përket propozimit mendoj përgjegjësia është e Kryetarit të komunës, është zyrtari më i lartë në komunë i cili duhet me u marrë së pari me stafin e tij me ua gjet mundësitë le ta bëjë propozimin, harmonizimin Kryetari i komunës dhe të del para Kuvendit, kjo është zgjidhje praktike le ta gjejë ai bazën ligjore. Sa i përket seancës që u cek është mirë me pas një vëmendje edhe Zyra ligjore me ardhur situata si ka shkuar dje në një seancë solemne me ligj dallohet seanca solemne kur thirret dhe seanca e jashtëzakonshme për një çështje neve na është ardhur ftesa për seancë solemne dhe kemi votuar në seancë solemne, nuk votohet, është dashur me ardhur seancë e jashtëzakonshme Vendimi për shpalljen e "Qytetar nderi" të Tony Blerit dhe m'u votuar.

Gëzim Sveçla: tha se edhe titullin e kanë gabuar se edhe thirrjen për seancë, neve duhet tri ditë më herët me na dërguar edhe me afat ligjor nuk na ka ardhur.

Fatos Dibra: tha tri ditë duhet më herët për mbledhjet e jashtëzakonshme.

Kryesuesi: tha unë kam menduar për seancën e ardhshme me mbajtur më 4 korrik, mirëpo KAB po u dashka m'u votuar para 30 nëse kemi mundësi e mbajmë seancë të rregullt, nëse jo mundemi edhe një seancë të jashtëzakonshme vetëm me këtë pikë të rendit të ditës, e seancën e rregullt e shtyjmë më 4 korrik. Në bazë të diskutimeve anëtarët u pajtuan që më datë 27 të mbahet Komiteti për Politikë dhe Financa, ndërsa seanca e Kuvendit më datë 28 nëse kryetari është i lirë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

**Procesmbajtësja
Shyhrete Islami**

**Kryesues i Komitetit
Fehmî Kupina**

